



308
26.03.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 774/3 Prot.

Tiranë më 26.3.2019

Lënda: Kërkohen propozimet e studentëve për rregulloren për zgjedhjen e Këshillave të Studentëve.

PROF.DR. SABRI LAÇI
DEKAN I FAKULTETIT TË HISTORISË DHE FILOLOGJISË

Me Vendimin e Senatit Akademik të UT-ës nr. 6, datë 14.02.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për zgjedhjen e Këshillave të Studentëve” është ngritur grupi i punës me anëtarë të Senatit Akademik për hartimin e rregullores për zgjedhjen e Këshillave të Studentëve. Në datën 25.03.2019 grupi i punës ka dorëzuar të firmosur nga 6 anëtarë materialin e hartuar, bashkëngjitur kësaj shkrese.


Në bazë të nenit 99, pika 4 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përpara se kjo draft rregullore të miratohet në Senatin Akademik, duhet të merren parasysh edhe propozimet e paraqitura nga studentët për këtë draft rregullore.

Përsa më sipër, brenda datës **10 Prill 2019** duhet të përcillni në formë shkresore dhe elektronike në adresën e emailit fjoralda.bakiri@unitir.edu.al, të gjitha propozimet e paraqitura nga studentët e fakultetit tuaj lidhur me rregulloren.

Të merren masa nga ana juaj për shpërndarjen e materialit të përgatitur nga grupi i punës tek të gjithë studentët duke u dhënë mundësi të gjithëve që të njihen me këtë material dhe të japin propozimet që ata mund të kenë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Shefave të departamenteve,
En keledes,
Sekretarimi Mësimor,
Te shpalltet në f2 dhe fb!
Te çohet lista e informuarve
studentit



DRAFT RREGULLORE

PËR

ZGJEDHJET E KËSHILLAVE STUDENTORË NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Këshillat Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës dhe për Këshillin Studentor të Universitetit të Tiranës, si edhe kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatën zgjedhore, rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore, kriteret për hartimin e listës të zgjedhësve, procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve, procedurat për shqyrtimin e ankimeve, si edhe rregullat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në nenin 99 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe nenet 130, 133 e 134 të Statutit të Universitetit të Tiranës, miratuar me Urdhërin nr. 816, datë 26.12.2018 të Ministres M.A.S.R.

Neni 3

Subjekti i rregullores

1.Kjo rregullore i shtrin efektet e saj për zgjedhjet e Këshillave Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës dhe për Këshillin Studentor të Universitetit të Tiranës.

2.Subjekt i saj janë studentët e programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master Shkencor e Profesional të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës.

3.Çdo student ka të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesit e vitit përkatës të programit të studimit që ai vetë vazhdon studimet.

Çdo student që ka ndjekur studimet rregullisht dhe pa asnjë ndërprerje përgjatë periudhës së tij të studimit ka të drejtën për t'u zgjedhur si përfaqësues në Këshillin Studentor të Fakultetit të tij, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore dhe me bazën ligjore të përcaktuar në nenin 2 të saj.

Neni 4

Parimet e përgjithshme

1. Zgjedhjet për Këshillat Studentorë të Fakulteteve të UT-së dhe të Këshillit Studentor të Universitetit të Tiranës, mbahen në mënyrë periodike, çdo 2 vjet.

1. 1.Këshillat Studentorë të Fakulteteve të UT-së, përbëhen nga 5 anëtarë, ku njëri prej tyre zgjidhet kryetar nga anëtarët e zgjedhur, me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të saj. Në rast barazimi votash përzgjedhja e kryetarit bëhet me

2. Anëtarët zgjidhen me votat e të gjithë studentëve të njësive kryesore, sipas vitit përkatës të programit të studimit.

Përfaqësimi i studentëve në Këshillat Studentorë të Fakulteteve të UT-së do të jetë si më poshtë:

- a. Një përfaqësues i studentëve të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor, viti i parë.
 - b. Një përfaqësues i studentëve të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor, viti i dytë.
 - c. Një përfaqësues i studentëve të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor, viti i tretë.
 - d. Një përfaqësues i studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor dhe Master Profesional, viti i parë.
 - e. Një përfaqësues i studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor dhe Master Profesional, viti i dytë.
2. Këshilli Studentor i UT-së, përbëhet nga kryetarët e Këshillave Studentorë të Fakulteteve, ku njëri prej tyre zgjidhet kryetar i Këshilli Studentor i UT-së, me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të saj. Në rast barazimi votash përzgjedhja e kryetarit bëhet me short, i cili organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i UT-së, në praninë e kandidatëve
3. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë e të fshehtë, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
4. Çdo votues ka të drejtën e një vote të vetme .
5. Çdo student i fakulteteve të UT-së mund të vetëkandidohet për t'u përzgjedhur vetëm në njërin nga komisionet zgjedhore të parashikuara në këtë rregullore, për UT-në ose fakultetin në të cilin studion.
6. Të drejtën për t'u zgjedhur si përfaqësues në këshillin studentor të fakultetit përkatës e ka çdo student që vetëkandidohet, sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
7. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe të zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cënuar procesin mësimor. Shpallet i zgjedhur në pozicionin e anëtarit të këshillit studentor të fakultetit përkatës, kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm (të cilët duhet të marrin 50%+1 të votave të vlefshme).
8. Çdo kandidat ka të drejtë të ketë vëzhguesit e tij në qendrën e votimit, në KZSF përkatës, si dhe në KIZS të UT-së. Listën me emrat e vëzhguesve kandidati e depoziton pranë KIZS, 3 ditë pas aplikimit të tij si kandidat.
9. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për anëtar të KSF bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i UT-së, në praninë e kandidatëve.

Neni 5

Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve

UT-së.

2. Në momentin e nisjes së këtij procesi , duhet të vihen në dijeni autoritetet drejtuese të UT-së.
3. Qendrat e votimit hapen në orën 9:00 dhe mbylLEN në orën 15:00. Askush nuk mund të votojë pasi komisionet e qendrave të votimit të fakulteteve të UT-së marrin vendim për mbylljen e votimit, pasi janë siguruar për votimin e të gjithë studentëve që janë në radhë, në pritje të votimit, në orarin e mbylljes së votimit.

KREUII PËRGATITJA DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 6

Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i Universitetit të Tiranës (KIZS)

Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i Universitetit të Tiranës, është organi përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor për Këshillat Studentor të Fakulteteve të UT-së dhe të Këshillit Studentor të Universitetit të Tiranës, i përbërë nga anëtarë, të cilët zgjedhin të mos kandidojnë për anëtarë të KSF.

Neni 7

Përbërja dhe funksionet e KIZS

1. KIZS në Universitetin e Tiranës, përbëhet prej 6 anëtarësh. Anëtarët e KIZS nuk mund të kandidojnë për anëtarë të KSF.
2. Dekanatet e fakulteteve përzgjedhin me short (në prani të studentëve të vetëkandiduar) dhe shpallin me vendim të Dekanit anëtarin përfaqësues në KIZS, nga 1 përfaqësues për çdo fakultet, jo më vonë se 10 ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore, nga lista e studentëve të vetëkandiduar të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës. Ky vendim i përcillet Rektoratit.
 - a) Në mbledhjen e parë, e cila thirret e drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë, KIZS zgjedh kryetarin me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të saj. Në rast barazimi votash përzgjedhja e kryetarit bëhet me short.
 - b) Gjatë periudhës zgjedhore, KIZS mblidhet jo më pak se 3 herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga 2 anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZS janë të hapura për çdo kandidat dhe vëzhguesit e tij.
 - c) KIZS i merr vendimet me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve (50%+1). Në rast barazimi votash, vota e kryetarit numërohet dy.
3. KIZS ka këto kompetenca:

a) organizimi dhe administrimi i procesit zgjedhor

KIZS;

- d) miraton vulën për KIZS, për KZSF dhe KQV të fakulteteve përkatëse, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi;
 - g) regjistron kandidatët për anëtar të KSF të Universitetit të Tiranës;
 - h) shpall rezultatin e zgjedhjeve për anëtar të KSF të Universitetit të Tiranës;
 - i) administron, gjykon dhe merr vendim për ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.
4. Mandati i anëtarit të KIZS ndërpritet në rastet kur:
- a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
 - b) jep dorëheqjen nga detyra;
 - c) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
 - e) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 mbledhje radhazi;
 - f) humbet statusin e studentit;
 - g) ndërron jetë.
5. Vendi i mbetur bosh në KIZS, plotësohet me short nga Dekanati përkatës brenda 24 orëve prej listave të studentëve të vetëkandiduar, të depozituara në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.
6. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të vuloset. Vendimet e komisionit firmosen prej të gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KIZS. Çdo anëtar i KIZS, krahas nënshkrimit të tij, mund të deklarojë në vendim votën kundër. Kohëzgjatja e mandatit të KIZS të Universitetit të Tiranës, është 2-vjeçare.

Neni 8 Komisioni i Apelimit Studentor (KAS)

1. KAS përbëhet prej 6 anëtarësh. Anëtarët e KAS nuk mund të kandidojnë për anëtarë të KSF .
2. Dekanatet e fakulteteve përzgjedhin me short (në prani të studentëve të vetëkandiduar) dhe shpallin me vendim të Dekanit anëtarin përfaqësues në KAS, nga 1 përfaqësues për çdo fakultet, jo më vonë se 10 ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore, nga lista e studentëve të vetëkandiduar, të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.
 - a) Në mbledhjen e parë, e cila thirret e drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë, KAS zgjedh kryetarin me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të saj. Në rast barazimi votash përzgjedhja e kryetarit bëhet me short.
 - a) Gjatë periudhës zgjedhore, KAS mblidhet vetëm për të marrë në shqyrtim kërkesat e drejtuara nga kandidatët. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë

- b) KAS i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij (50% + 1). Në rast barazimi votash, vota e kryetarit numërohet dy.

3.KAS-i ka këto kompetenca:

- a) shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe mendimet "kundër", për çdo ankim për vendime të marra prej KIZS;
- b) administron, gjykon dhe merr vendim për ankimimet që regjistrohen prej kandidatëve;
- c) dërgon për dijeni në KIZS vendimet e marra për ankesat që janë paraqitur pranë tij.
- d) vendimi i KAS është i detyrueshëm për t'u zbatuar.

4.Mandati i anëtarit të KAS-it ndërpritet në rastet kur:

- a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
- b) jep dorëheqjen nga detyra;
- c) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- d) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rendë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
- e) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 mbledhje radhazi;
- f) humbet statusin e studentit;
- g) ndërrohet jetë.

5.Vendi i mbetur bosh në KAS plotësohet nga dekanati përkatës, brenda 24 orëve, prej listave të studentëve të vetëkandiduar, të depozituara në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.

6.Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të vuloset. Vendimet e komisionit firmosen prej të gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KAS. Çdo anëtar i KAS, krahas nënshkrimit të tij, mund të deklarojë në vendim votën kundër. Kohëzgjatja e mandatit të KAS të Universitetit të Tiranës, është 2-vjeçare.

Neni 9 Komisionet e Zgjedhjeve Studentore në Fakultete (KZSF)

1. Vendimi për ngritjen e KZSF merret nga KIZS jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e formimit të saj.
2. Anëtarët e KZSF nuk kanë të drejtë të kandidojnë për anëtarë të KSF.

Anëtarët e KZSF të fakulteteve të UT-së do të zgjidhen me short nga KIZS, nga lista e studentëve të vetëkandiduar për këtë komision(në prani të tyre), të cilët regjistrohen pranë këtij komisioni.


kryetarit bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i UT-së, në praninë e kandidatëve.

4. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet firmosen prej gjithë anëtarëve të KZSF. Ditën e votimit, vendimet e marra firmosen dhe vulosen nga KZSF me vulën e marrë nga KIZS bashkë me materialet zgjedhore.
5. KZSF i marrin vendimet me shumicë të thjeshtë (50%+1) të të gjithë anëtarëve të tyre.
6. KZSF kanë këto kompetenca:
 - a) përgjigjen për administrimin dhe zhvillimin e procedurave të votimit për trupën zgjedhore të fakultetit përkatës;
 - b) pas përfundimit të procesit të votimit, marrin në dorëzim kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të KQV përkatëse dhe, më pas, fillojnë procesin e numërimit të votave për anëtar të KSF, rezultatin e të cilave e pasqyrojnë në procesverbalet dhe tabelat përkatëse.
 - c) hartojnë tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit të KQV përkatëse dhe shpallin, me vendim të veçantë, rezultatet e votimeve për anëtarët e KSF.
7. Mandati i anëtarit të KZSF ndërpritet në rastet kur:
 - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
 - b) jep dorëheqjen nga detyra;
 - c) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
 - d) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 mbledhje radhazi;
 - e) humbet statusin e studentit;
 - f) ndërron jetë.
8. Vendi i mbetur bosh plotësohet me short nga KIZS(në prani të studentëve të vetëkandiduar) brenda 24 orëve nga lista e kandidatëve që janë vetëkandiduar për këtë komision.
9. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të vuloset. Vendimet e komisionit firmosen prej të gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KZSF. Çdo anëtar i KZSF, krahas nënshkrimit të tij, mund të deklarojë në vendim votën kundër. Kohëzgjatja e mandatit të KZSF, është 2-vjeçare.

Neni 10

Komisionet e qendrave të votimit

1. Vendimi për ngritjen e KQV të fakulteteve të UT-së merret nga KZSF përkatëse jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e formimit të KZSF.
2. Anëtarët e KQV nuk kanë të drejtë të kandidojnë për anëtarë të KSF-ve.



KIZS cakton kryetarin e KQV me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të saj.

3. KQV kanë këto kompetenca:

- a) përgjigjen për administrimin dhe zhvillimin e procedurave të votimit për trupën zgjedhore të qendrës së votimit;
- b) pas përfundimit të procesit të votimit, i dërgojnë kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore në KZSF sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 11 **Qendrat e votimit**

1. Votimi kryhet në qendrat e votimit, ku për çdo 1 000 studente ngrihet një qendër votimi pranë Fakulteteve.
2. Në të gjitha qendrat e votimit votohet për anëtarë të KSF .

KREU III **ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE**

Neni 12 **Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve**

1. Kanë të drejtën e zgjedhjes studentët e programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master Shkencor e Master profesional të fakulteteve të UT-së.
2. Kanë të drejtën për të kandiduar të gjithë studentët e programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master Shkencor e Master Profesional të fakulteteve të UT-së, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.
3. Kandidatët për anëtarë të KSF nuk mund të kandidojnë për anëtarë të komisioneve zgjedhore.
4. Organi përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve është sekretaria mësimore e fakultetit përkatës, duke ndarë më vete listat sipas secilit program studimi dhe vitit përkatës .
5. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë vijon:
 - a) Lista paraprake e studentëve hartohet nga sekretaria mësimore jo më vonë se 3 ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.
 - b) Lista paraprake afishohet në mjediset e fakulteteve përkatëse.

179

[Signature]

orësh.

- e) Pas përfundimit të afatit për korrigjimin e listës, sekretaria mësimore harton listën përfundimtare, e cila miratohet nga Dekani i fakultetit përkatës.
6. Lista e zgjedhësve afishohet në mjediset e fakultetit përkatës dhe në faqe zyrtare në internet dhe një kopje e listës i dërgohet KIZS. Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe prej Dekanit dhe e vulosur me vulën e fakultetit përkatës.

KREU IV

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT STUDENTOR TË FAKULTETIT DHE FUSHATA ZGJEDHORE

Neni 13

Regjistrimi kandidatëve

1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për anëtar të KSF bëhet nga KIZS. Data për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve shpallet prej KIZS pas ditës së konstituimit të tij dhe zgjat 10 ditë kalendarike.
2. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 14

Dokumentacioni për kandidim

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZS dhe përmban:
 - a) kërkesën për kandidim e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim për anëtar të KSF;
 - b) fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
 - c) vërtetimin që provon se është student pranë fakultetit përkatës;
 - d) **Listën e notave.....**
Kriteri i notës mesatare të përcaktohet në mbledhjen e Senatit Akademik duke u marrë mendimet nga përfaqësues më të zgjëruar të fakulteteve përkatëse.

Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZS, jo më vonë se 24 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listat e kandidatëve për anëtarë të KSF, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Listat përcillen në komisionet zgjedhore studentore të fakulteteve dhe shpallen publikisht nga këto të fundit menjëherë në mjediset e fakultetit përkatës dhe në faqen zyrtare në internet.

Neni 15

Kohëzgjatja e mandateve

Anëtarët e KSF zgjidhen për një mandat 2-vjeçar.

Neni 16
Fushata zgjedhore

1. Fushata zgjedhore fillon një ditë pas shpalljes së kandidatëve të regjistruar.
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
3. Administratori dhe administrata e fakulteteve të UT-së, krijojnë kushte të përshtatshme dhe të barabarta për të gjithë kandidatët për të zhvilluar aktivitetin e tyre në kuadër të fushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e fakulteteve të UT-së, merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, pa çenuar procesin mësimor, si dhe përcakton mjediset dhe plotëson kërkesat e komisioneve të ngritura në fakultetin përkatës, me qëllim zhvillimin e zgjedhjeve.

KREUV
PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT PËR ZGJEDHJET

Neni 17
Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe vendeve të numërimit të votave

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) Selia e KIZS vendoset në godinën e Rektoratit të UT-së.
 - b) Selitë e KZSF dhe KQV vendosen në godinat përkatëse të fakulteteve të UT-së, të cilat shërbejnë edhe si vendet e votimit dhe numërimit të votave.

Neni 18
Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave

1. Votat vlerësohen dhe numërohen prej KZSF përkatëse.
2. KZSF përkatëse të UT-së, pas numërimit të votave, plotësojnë tabelën zgjedhore dhe ia përcjellin atë KIZS.
3. KIZS shpall rezultatet e zgjedhjeve sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe, pas kalimit të afateve për ankimin, shpall fituesit e zgjedhjeve.

Neni 19
Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor

1. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listave përkatëse.
2. Forma e fletës së votimit përgatitet prej KIZS.
3. Fletët për anëtarë të KSF përkatës të UT-së, kanë të njëjtën ngjyrë për të gjitha qendrat e votimit.
4. Fleta duhet të jetë me specifika të tilla që të mos lejojnë manipulimin e tyre; janë prej letreformat

- b) Të gjitha fletët e votimit vulosen me vulën e KIZS përpara se të dërgohen në KZSF.

Neni 20

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZS në KZSF

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve, KIZS dërgon në KZSF kutinë me materialet zgjedhore, si më poshtë vijon:
 - a) fletët e votimit të vulosura me vulën e KIZS në përputhje me numrin e votuesve ;
 - b) listën e zgjedhësve;
 - c) vulën e KZSF dhe vulat e KQV të secilit fakultet;
 - d) procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
 - e) zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të dëmtuara"
 - f) zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura"
 - g) zarfin në të cilin është shënuar "Zarf i procesverbalit të vulosjes"
2. Përveç kutisë me materialet zgjedhore, në KZSF dërgohen edhe kutitë e votimit, tabelat për rezultatin e zgjedhjeve; dhomat e fshehta dhe vulat me kodet e sigurisë.
3. KZSF shpërndan bazën materiale të nevojshme për zhvillimin e votimit në KQV të ngritura në fakultetin përkatës. Ky proces bëhet ditën e zgjedhjeve, përpara fillimit të procesit të votimit, si dhe pasqyrohet në procesverbalin përkaës.

KREU VI

VOTIMI

Neni 21

Veprimet paraprake për hapjen e qendrës së votimit

1. Në çdo qendër votimi votohet në një kuti votimi, kutia e votimit për anëtarë të KSF përkatës të UT-së.
2. KZSF dhe KQV, nën drejtimin e kryetarit, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit, kryejnë këto detyra:
 - a) vendosin tryezat, karriget, dhomat e fshehta dhe kutitë e votimit, në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, si edhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
 - b) afishojnë udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
 - c) kontrollojnë të gjitha materialet e marra në dorëzim;
 - d) u tregojnë të pranishmëve kutitë e votimit të zbrazëta;
 - e) mbyllin kutitë e votimit dhe i shkruajnë këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e

kutinë e votimit. Anëtarët e KZSF dhe KQV marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

Neni 22 Procedurat e votimit

1. Votimi për anëtarë të KSF bëhet në datën e caktuar nga Rektorati i UT-së. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZSF dhe KQV deklaron hapjen e votimit, por jo më vonë se ora 09:00.
2. Fletët e votimit janë të vulosura në pjesën e pasme, në vendin e caktuar, me vulën e KIZS. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtari të komisionit. Pasi zgjedhësi hyn në qendrën e votimit:
 - a) thotë emrin e tij dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identifikimit:
 - letërjoftim ID;
 - pasaportë.
 - b) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
 - c) nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
 - d) kryetari vulos fletën e votimit me vulën e KQV dhe ia jep zgjedhësit.
 - e) pasi merr fletët e votimit, hyn në dhomën e fshehtë dhe në krah të emrit të kandidatit' shënon shenjën "x" ose "+", ose çdo shenjë tjetër brenda kuadratisht të përcaktuar për shënim nga ana e zgjedhësit.
 - f) pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.
3. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës.
4. Në qendrën e votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit.
5. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
 - a) anëtarët KQV dhe vëzhguesit e miratuar nga KIZS për llogari të kandidatëve;
 - b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit, deri në përfundim të tyre.

2. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e KQV.

Neni 24

Veprimet pas mbylljes së qendrës së votimit

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari i KQV, në praninë e anëtarëve të komisionit kryen, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
 - a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, të cilët kanë votuar sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore.
 - b) iu deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të komisionit;
 - c) i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij.
2. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, i numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit numëron edhe fletët e papërdorura dhe i vendos ato në zarfin përkatës. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Kryetari i KQV, bashkë me anëtarët e tjerë të komisionit, dorëzojnë në KZSF përkatës kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të qendrës së votimit.

Neni 25

Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për anëtarë të KSF të UT-së

1. Procesi i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për anëtarë të KSF të UT-së vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin përkatës.
2. Kryetari i KZSF nxjerr nga kutia e votimit fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj, ai:
 - a) vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të KZSF. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë;
 - b) numëron votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal;
 - c) verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të gjenden në kuti, në bazë të të dhënave të procesverbalit të hartuar më parë nga KQV përkatëse, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, në lidhje me numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletëve të votimit të papërdorura dhe fletëve të votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal;

- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZS;
 - b) fletës së votimit i mungon vula;
 - c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
 - d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të studentit kandidat;
 - e) është votuar në tejkalim të përcaktimeve në fletët e votimit;
 - f) nuk është votuar për asnjë kandidat.
2. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZSF harton tabelën përfundimtare të rezultatit të votimit sipas numrit të votave.
 3. Tabela përfundimtare dhe vendimi përkatës i KZSF, si edhe të gjitha procesverbalet e tjera nënshkruhen nga të gjithë anëtarët dhe kryetari, duke deklaruar votën "pro" ose "kundër".
 4. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të votimit u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.
 5. Çdo kontestim apo vërejtje e kandidatëve shënohet detyrimisht në procesverbal.
 6. Në përfundim të procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave, në prani të kryetarit e anëtarëve KZSF dhe/ose kandidatëve të pranishëm;
 - a) futen dhe administrohen në kutinë e votimit fletët e votimit të numëruara të vlefshme dhe të pavlefshme;
 - b) futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi 'Fletë votimi të papërdorura';
 - c) futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi 'Fletë votimi të dëmtuara'
 - d) futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore procesverbali për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara, si edhe tabela përfundimtare e rezultatit të votimit për KZSF përkatëse.
 7. Kryetari i KZSF mbyll kutitë e votimit dhe shënon në procesverbal elementet e sigurisë (kodet) për mbylljen e këtyre kutive.
 8. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit në KIZS bëhet nga kryetari i KZSF, me procesverbal, në prani të anëtarëve të KZSF përkatëse dhe/ose kandidatëve, menjëherë pas përfundimit të proceseve të përshkruara në këtë rregullore.

Neni 26

Shpallja e rezultatit paraprak të zgjedhjeve për KSF të UT-së

1. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, nxjerrjes së rezultatit të votimit nga gjithë KZSF dhe dërgimit të tyre në KIZS, ky i fundit, brenda 24 orëve, harton tabelën e rezultateve të votimit dhe shpall, me vendim të veçantë, rezultatet e zgjedhjeve për anëtarët e KSF përkatës të UT-së.
2. Tabela e rezultateve zgjedhore dhe vendimi i KIZS nënshkruhen nga të gjithë anëtarët:

tyre. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas dy ditëve kalendrike. KIZS administron dhe merr vendime për ankimimet jo më vonë se 48 orë pas paraqitjes së tyre.

2. Kundër vendimeve të KIZS për ankesat e kandidatëve për rezultatin e zgjedhjeve, apelimi i vendimit bëhet nga kandidatët në Komisionin e Apelit Studentor (KAS) jo më vonë se 2 ditë kalendrike nga data e marrjes së vendimit. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendrike.
3. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimimeve të dërguara nga Komisioni i Apelit Studentor, KIZS shpall, me vendim të veçantë, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Neni 28

Pavlefshmëria e zgjedhjeve

1. KIZS, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi, në rast se:
 - a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;
 - b) mund të jetë cënuar procesi zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
 - c) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkuar duhet ta shoqërojë me shpjegimin për arsyet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën bëhet nga KIZS, jo më vonë se 2 ditë kalendrike nga depozitimi i saj.

Neni 29

Mbledhja e kostituimi i KSF dhe KSUT

1. Pas përfundimit të afateve të apelit, organizohen mbledhjet e para të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të UT-së, të cilat thirren nga KIZS jo më vonë se dy javë nga ky afat. Në këto mbledhje bëhet konstituimi i tyre dhe zgjedhin kryetarët e KSF sipas përcaktimeve në këtë rregullore. Kjo datë shënon edhe fillimin e punës së Këshillit Studentor të Fakultetit.
2. Jo më vonë se 7 ditë mbas këtij procesi, organizohet mbledhja e para e Këshillit Studentor të UT-së, e cilat thirret nga KIZS. Këshilli Studentor i UT-së përbëhet nga 6 kryetarët e KSF. Në këtë mbledhje bëhet konstituimi i tij dhe zgjedhja e kryetarit të KSUT sipas përcaktimeve në këtë rregullore. Kjo datë shënon edhe fillimin e punës së KSUT.

3. Pas zhvillimit të zgjedhjeve dhe nxjerrjes së rezultatit, si edhe kriimit të Këshillit të Studentëve

NENI 30

NJOFTIMET

Të gjitha aktet e nxjerra nga strukturat e përfshira në procesin e zgjedhjeve të Këshillave Studentorë të UT-së duhen të afishohen në ambjentet e Universitetit të Tiranës dhe në faqet zyrtare në internet.

Neni 30

Dispozita të fundit

1. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivën e KSUT, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
2. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarëve të KSF përkatëse, ata zëvendësohen nga kandidatët pasardhës në rënditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhje, deri në përfundim të mandatit të nisur.
3. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Senati Akademik i UT-së i cili e miraton këtë rregullore.
4. Të gjitha shpenzimet për procesin zgjedhor do të mbulohen nga fakultetet e UT-së dhe Rektorati.
5. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha strukturat studentore të Universitetit të Tiranës, dhe hyn në fuqi mbas miratimit të saj nga Senati Akademik i UT-së.

